

REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS VLAĐA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-6765
Nr. i faqëve Br. stranica No. pages	-4-	Data: Datum: Date:	08/10/2018

Prishtinë / a

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur në mes të:

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS (MI)

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË (MSH)

AGJENCISË QENDRORE TË PROKURIMIT (AQP)

KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS (KEK)

dhe

INSTITUTIT DEMOKRATIK TË KOSOVËS (KDI)

A.Q.P.

114

47/18

03.10.2018

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	02	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	9354
Nr. i faqëve Br. stranica No. pages	04	Data: Datum: Date:	03.10.18

PRISHTINE

Prishtinë
03.10.2018

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

08-10-2018

Nr. 6842

PRISHTINË-A

Palët e lartcekura me qëllim të thellimit të bashkëpunimit afatgjatë në fushëveprimin e vet, lidhin këtë:

“MEMORANDUM BASHKËPUNIMI”

Neni 1

QËLLIMI I MEMORANDUMIT

1. Fuqizimi i bashkëpunimit të institucioneve publike me sektorin jo-qeveritar, rritja e llogaridhënies, transparencës dhe qeverisjes së mirë në procesin e prokurimit në institucionet publike në Kosovë, duke u bazuar edhe në zotimet e Qeverisë së Kosovës, në Samitin e Londrës Kundër Korrupsionit 2016, raportet e Komisionit Evropian dhe sygjerimet e Qeverisë së Britanisë së Madhe, për përforcimin e zbatimit të legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e prokurimit publik si dhe aplikimin e prokurimit elektronik në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik.
2. Palët pajtohen që të nënshkruajnë këtë dokument, për të bashkëpunuar në këto fusha:
 - 2.1. Identifikimi i problemeve në procesin e prokurimit publik përmes shqyrtimit të disa kontratave në faza të ndryshme të prokurimit;
 - 2.2. Ofrimin e rekomandimeve të dalura pas procesit të monitorimit të tenderëve;
 - 2.3. Rritjen e përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese për të shmangur praktikatat e dëmshme në hartimin e kritereve për tender;
 - 2.4. Rritjen e përgjegjësisë së autoriteteve kontraktuese për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e kontratave publike;
 - 2.5. Nxitjen e autoriteteve kontraktuese për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies që do të ndikojnë në informimin e qytetarëve në shpenzimet e fondeve publike.

Neni 2

PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE

2. Përmes këtij Memorandum Bashkëpunimi, për të arritur objektivat, institucionet marrin për obligim që të:
 - 2.1. Sigurojnë transparencë në procedurat e prokurimit publik në të gjitha fazat;
 - 2.2. Ofrojnë qasje në dosjet e tenderëve bazuar në ligjin për qasje në dokumente publike, dhe përgjegjësitë e këtij memorandumi;
 - 2.3. Ofrojnë qasje për monitorim të kontratave gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave/realizimit në teren;
 - 2.4. Ofrojnë gadishmëri për adresim të rekomandimeve nga KDI, të dalura nga monitorimi i procesit të prokurimit.

Neni 3

PËRGJEGJËSITË E KDI-SË DHE PALËVE

1. KDI me përvojën e gjatë në monitorimin e prokurimit publik në shumë institucione të Kosovës, përmes këtij memorandumi merr përsipër që të:

1.1. Identifikoj problemet e hasura në fazat e ndryshme të procesit të prokurimit publik dhe t'i paraqes ato tek personat përgjegjës brenda autoritetit kontraktues përkatës;

1.2. Ofroj rekomandime në lidhje me përmirësimin e sistemit të prokurimit për aktivitetet në të cilat paraqiten mangësi apo të ngjashme duke u bazuar në rezultatet e monitorimit aktiv të autoritetit kontraktues;

1.3. Rekomandoj përmirësimin e politikave dhe procedurave të cilat do të ndikojnë në eliminimin e pengesave të hasura gjatë monitorimit të kontratave publike;

1.4. Ndikoj në rritjen e transparencës në prokurim publik, me anë të publikimit të raporteve analitike lidhur me kontratat publike të autoritetit përkatës.

1.5. Obligohet KDI të kujdeset për ruajtjen e konfidencialitetit të dokumenteve, shkresave, letrave të ndryshme tek të cilat mund të ketë qasje gjatë zbatimit të këtij memorandumi, të cilat mbrohen me ligjin në fuqi apo obligimet kontraktuale, pa e kufizuar atë në zbulimin apo publikimin e shkeljeve kontraktuale apo shkeljeve të tjera, nën përgjegjësinë ligjore të KDI-së.

2. Palët do të mbështesin projektet reciproke, do të ndërmarrin iniciativa të përbashkëta me qëllim që të realizojnë projektet nga fusha e këtij Memorandum Bashkupnimi.

3. Palët nënshkruese dhe KDI pajtohen të mbajnë raporte të mira në fazën e implementimit të këtij memorandumi, duke respektuar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e KDI-së si organizatë e pavarur, politikisht e pa anshme dhe profesionale.

Neni 4

NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT

1. Ky memorandum mund të amendamentohet me pajtimin e palëve nënshkruese në çdo kohë kur vërehet se është e nevojshme.

2. Amendamentimet në këtë Memorandum Bashkupnimi mund të bëhen përmes marrëveshjes së përbashkët me shkrim nga të gjitha palët, vetëm me një njoftim paraprak.

Neni 5

KOHËZGJATJA E MEMORANDUM BASHKËPUNIMIT

1. Ky Memorandum bashkupnimi ka vlefshmëri deri në mars të vitit 2021.

2. Memorandumi është i aplikueshëm për të gjithë stafin civil dhe politik të institucioneve nënshkruese.

Neni 6
E TËRË MARRËVESHJA

Teksti i këtij memorandumi është marrëveshja e vetme e pajtuar në mes të palëve. Asgjë në këtë memorandum nuk nënkupton heqje dorë nga një e drejtë, detyrim apo kompetencë e MI-së, MSh-së, AQP-së dhe KEK-ut e paraparë me ligjet në fuqi.

Neni 7
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet eventuale në mes të palëve nënshkruese do të zgjidhen me mirëkuptim të ndërsjellë.


Neni 8
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI E KËTIJ MEMORANDUM
BASHKËPUNIMI

1. Memorandumi është i përpiluar në dhjetë ekzemplar me përmbajtje të njejtë, prej të cilave pas nënshkrimit dhe protokollimit nga dy ekzemplarë do të mbes secilës palë.
2. Memorandumi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të gjitha palët.


Ministri i Infrastrukturës
Pal LEKAJ




Ministri i Shëndetësisë
Uran ISMAILI



Drejtor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
Behxhet RRUKIQI



Kryesues i Bordit të Drejtoreve të Korporatës Energjetike të Kosovës
Faruk HAJRIZI



Drejtori i KDI-së
Ismet KRYEZIU

